

Nr 11197 Prot

28.06.21

Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a

Pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Së bashku me Raportin e Audituesve të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR	1-3
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	8-43

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Drejtuesit e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a.

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e konsoliduar të fitim ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për periudhën e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat e konsoliduara financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion me Rezervë

Arsyet e mëposhtme janë bazat për dhënien e opinionit me rezervë:

1. Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përfshin, aktive në proces me vlerë 2,187,135 mijë Lekë (2019: 1,816,490 mijë Lekë) të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (DPUK). Pavarësisht dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Shoqëria për gjendjen e aktiveve në proces më 31 dhjetor 2020 ky informacion është i pamjaftueshëm për të dhënë siguri në lidhje me balancat e aktiveve në proces në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse rregullime për aktivet në proces janë të nevojshme më 31 dhjetor 2020.
Gjithashtu, shoqëria ka aktive të tjera në proces në vlerën 2,036,244 mijë lekë të cilat janë të krijuara nga periudhat e mëparshme dhe nuk janë marrë ende në dorëzim nga shoqëria. Këto aktive janë të vlerësuara me kosto. Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 36 "Zhvlerësimi i aktiveve", njësia ekonomike duhet të kryejë një vlerësim të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndonjë indikacion për ndonjë rënie vlere nga zhvlerësimi. Nëse identifikohen raste të tilla, njësia ekonomike kërkohet të bëjë një vlerësim të shumës së rikuperueshme të aktiveve të saj. Megjithatë ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim të shumës së rikuperueshme për keto aktive në proces. Bazuar në informacionin që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë rregullim i mundshëm që vjen nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në proces do të ketë në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së rikuperueshme të tij do të ulë proporcionalisht aktivet dhe kapitalin e pronarit.
2. Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përmban llogari të arkëtueshme në vlerë bruto 5,335,606 mijë lekë (më 31 dhjetor 2019: 4,514,677 mijë lekë). Për keto shuma, nisur nga natyra e aktivitetit që ka një volum të madh të abonentëve dhe faturimeve, shoqëria ka kryer çmuarje për zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme në përputhje me analizën e përshkruar në shënimin 5 të pasqyrave financiare "*Vlerësimet dhe gjykime kritike të kontabilitetit*".
Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme siç kërkohet në përputhje me kërkesat e SNRF 9 "Instrumentet Financiare" i cili kërkon vlerësim individual ose kolektiv për balancat e arkëtueshme bazuar në analizë të plotë mbështetur mbi të dhëna historike.
Si rrjedhojë, në mungesë të zbatimit të një metodologjie e cila të jetë në përputhje me kërkesat e SNRF 9 "Instrumentet Financiare", ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjet e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020.

Bazat për Opinion me Rezervë (vazhdim)

Për më tepër, vlerësimi i shoqërisë përfshin vetëm të arkëtueshmet sipas faturimeve nëpërmjet sistemit Oracle. Pavarësisht kjo shumë bruto e llogarive të arkëtueshme nuk rakordon me vlerën e llogarive të arkëtueshme të shprehura në pasqyrat financiare për vlerën 317,362 mijë Lek (2019: 105,905 mijë).

3. Shuma e "Huamarrjeve afatshkurtra" në Pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit është 3,124,003 mijë lekë (më 31 dhjetor 2019: 2,577,461 mijë Lekë). Nga kjo shumë, vlera prej 1,205,077 mijë Lekë nuk është regjistruar në monedhën origjinale, që në vitin e parë të marrjes në kontabilitet, por vetëm në monedhën lokale Lekë. Për pasojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet e ndonjë rivlerësimi të mundshëm me kursin e fundvitit sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 21 "Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit".
Gjithashtu, Shoqëria nuk ka kryer njohjen me vlerë të drejtë në ditën e parë të marrjes së huave si dhe nuk ka aplikuar me pas metodën e kostos së amortizuar mbi huatë e marra siç kërkohet në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9. Si rrjedhojë, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm në lidhje me detyrimet e huave dhe elementet që përbëjnë pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.
4. Gjendja e granteve qeveritare në Pasqyrën e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit është 1,701,176 mijë Lekë. Ne nuk na janë vënë në dispozicion dokumenta justifikues të duhur dhe të mjaftueshëm për gjendjen e granteve qeveritare në vlerën 237,002 mijë Lekë (31 dhjetor 2019: 182,062 mijë Lekë). Ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me ekzistencën dhe plotësinë e këtyre granteve. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera në përputhje me Ligjin 25/2018, datë 19 janar 2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.

Raporti i ecurisë së veprimtarisë përfshirë raportin jo-financiar parashikohen të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Pasi të lexojmë raportin e ecurisë së veprimtarisë përfshirë raportin jo-financiar, nëse arrijmë në përfundimin se në këto raporte ka një gabim material, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare (vazhdim)

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tone.

Tiranë, 28 qershor 2021

Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

mazars
Emin Duraku Str., Binjakët 2, Nr. 5,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUI: K32123006W

Irena Pulo (Hoxha)
Auditues Ligjor

Sokol Toska
Auditues Ligjor



Pasqyra e konsoliduar e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë material	6	20,362,567	18,304,219
Te drejtë në përdorim	7	131,211	95,069
Parapagime për aktive të tjera afatgjatë	8	19,351	19,351
Totali i aktiveve afatgjatë		20,513,129	18,418,639
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	9	471,155	485,789
Llogarite e arketueshme	10	4,561,564	3,885,803
Llogari të arketueshme të tjera	11	387,366	345,960
Tatimi mbi fitimin	12	87,252	81,500
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13	61,941	39,925
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	356,203	245,900
Totali i aktiveve afatshkurtra		5,925,481	5,084,877
Totali i aktiveve		26,438,610	23,503,516
KAPITALI			
Kapitali aksionar		6,792,760	6,792,760
Rezerva të tjera		841,251	729
Rezerva rivlerësimi		109,541	158,323
Rezerva ligjore		110,603	61,640
Fitime të mbartura		1,759,840	1,763,323
Fitimi i ushtrimit		380,136	886,002
Totali i kapitalit	15	9,994,131	9,662,777
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	16	6,235,121	5,428,599
Detyrime afatgjatë të qirasë financiare	17	99,819	63,954
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	18	1,701,176	1,674,356
Totali i detyrimeve afatgjatë		8,036,116	7,166,909
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	19	3,124,003	2,577,461
Detyrime afatshkurta të qirasë financiare	17	35,573	33,908
Llogari të pagueshme tregtare	20	4,867,771	3,723,569
Detyrime ndaj personelit	21	62,344	59,624
Të pagueshme të tjera	22	34,203	4,787
Provizione	23	39,624	50,120
Detyrime tatimore	24	30,482	56,693
Tatim fitimi i shtyrë	25	214,363	167,668
Totali i detyrimeve afatshkurtra		8,408,363	6,673,830
Totali i detyrimeve		16,444,479	13,840,739
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		26,438,610	23,503,516

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 8-43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
(Vlerat janë në mijë Lekë)
Pasqyra e konsoliduar e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	26	3,920,921	4,271,976
Të ardhura të tjera	27	134,797	251,292
Total të ardhura		4,055,718	4,523,268
Shpenzimet e prodhimit	28	(801,041)	(778,210)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(413,391)	(394,267)
Renia në vlerë e emrit të mire		-	(202,663)
Shpenzime zhvlerësimi konsum i inventarit të imët		(389)	-
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	29	(924,561)	(1,028,501)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari të arkëtushme		(145,167)	10,405
Rimarrje/(Shpenzime) provizione të tjera		-	-
Rimarrje/(Shpenzime) provizione për ështëje gjyqësore		18,379	22,111
Shpenzime personeli	30	(1,075,017)	(1,043,519)
Total shpenzime		(3,341,187)	(3,414,644)
Shpenzimet financiare (neto)	31	(163,910)	(100,124)
Fitim (humbje) nga këmbimet valutore	32	(66,776)	47,431
Fitimi/humbja para tatimit		483,845	1,055,931
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(103,709)	(169,929)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	33	(105,795)	(172,749)
Tatim i shtyrë		2,086	2,820
Fitimi/humbja e vitit		380,136	886,002
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(48,781)	(24,019)
Zëra nuk do të kalifikohen në fitim ose humbje		(48,781)	(24,019)
Tatim i shtyrë nga rivlerësimi		(48,781)	(24,019)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(48,781)	(24,019)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		331,355	861,983

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 8 - 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
(Vlerat janë në mijë Lekë)

Pasqyra e konsoliduar ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Pozicioni financiar më 1 janar 2019	Kapitali aksionar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
	6,792,760	193,217	8,198	729	804,492	1,012,273	8,811,669
Transferim në fitime të mbartura dhe rezerva Fitimi/humbja e vitit	-	-	53,442	-	958,831	(1,012,273)	-
Tatim i shtyrë nga rivlerësimi	-	(24,019)	-	-	-	886,002	886,002
Dalje e rezervave nga UK Kamez	-	(17,851)	-	-	-	-	(17,851)
Tatim i shtyrë nga rivlerësimi	-	6,976	-	-	-	-	6,976
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	6,792,760	158,323	61,640	729	1,763,323	886,002	9,662,777
Transferim në fitime të mbartura dhe rezerva Fitimi/humbja e vitit	-	-	48,963	840,522	(3,483)	(886,002)	-
Tatim i shtyrë nga rivlerësimi	-	(48,782)	-	-	-	380,136	380,136
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	6,792,760	109,541	110,603	841,251	1,759,840	380,136	9,994,131

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 8 – 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të konsoliduara së bashku me shënimet shpjeguese më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga Menaxhimi i shoqërisë më 28 qershor 2021 dhe u nënshkruan si më poshtë nga:


Z. Ekona Kacidhja
Drejtor i Përgjithshëm


Znj. Elizabeta Cjapi
Drejtoreshë Ekonomike

Pasqyra e konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	483,845	1,055,931
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	413,390	394,267
Rënie në vlerë Emri i mirë	-	202,663
Zhvlerësim/(rimarrje) e llogarive të arketushme	145,167	(10,405)
Rimarrje inventari	(10,106)	-
Të ardhura të tjera jomonetare	(82,862)	(20,215)
Të ardhura nga rimarrja e grantit	(47,396)	(50,164)
Provizione	(10,496)	(22,110)
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues:</i>		
Rënie/(ritje) në inventar	24,740	(22,347)
(Rritje)/rënie në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(763,868)	688,307
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	1,256,480	(35,076)
Rënie e detyrimeve ndaj personelit dhe shtetit	(129,286)	(349,041)
Rritje në parapagime të arkëtuara	(22,016)	(21,208)
Rritje/(rënie) në parapagime e shpenzime të shtyra	(5,752)	8,045
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	1,251,840	1,818,647
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(98,466)	(412,108)
	(98,466)	(412,108)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(2,427,013)	(1,850,152)
Ndryshim në aktive afatgjata	(4,890)	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(2,431,903)	(1,850,152)
Aktivitetet financuese		
Rritje i huave nga insitucione të tjera	806,522	242,935
Rritje e detyrimeve për grante	74,216	18,190
Rritje e huave afatshkurtra (Kësti afashkurtër)	546,542	286,100
Pagesa të qirave financiare	(38,448)	(35,207)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	1,388,832	512,018
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	110,303	68,405
Mjetet monetare në fillim të periudhës	245,900	177,495
Mjetet monetare në fund të periudhës	356,203	245,900

14

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 8 – 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

1.1 Informacion ligjor

Pasqyrat financiare të Grupit paraqesin konsolidimin e aktiviteteve të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha që është shoqëria mëmë dhe HEC Lanabregas sha.

Më datën 27.09.2017 është regjistruar shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sha pranë QKB-së me NIPT L72320033P sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 8 datë 27.09.2017.

Adresa ligjore UKT sha është në: Rruga e Kavajës, Ndërtesa 133, Njësia Administrative 6, Tiranë. Shoqëria është subjekti i regjistruar në TVSH.

Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 1,290 punonjës.

Me vendim nr. 13 datë 23.11.2017 të Aksionarit të vetëm Bashkia Tiranë, të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, Bashkia Tiranë është 100 % aksionar me kapital aksioner prej 6,792,760,000 lekë, aksione 6.792.760 me vlerë nominale Lek 1000/aksion.

Shoqëria ka regjistruar pranë QKB –së administrator ligjor Z.Elton Kacidhja, me mandat 3 vjeçar i cili përfundon më 16.10.2023 , ndërkaq që ajo mbikqyret nga Këshilli i Administrimit.

Shoqëria operon në aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjes së tij. Mirëmbajtje e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantëve të pastrimit të tyre.

Pasqyrat e konsoliduara të Grupit përfshijnë vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Marrëveshja e Ndarjes

Në bazë të Marrëveshjes së Ndarjes në datën 27.09.2017 u vendos që UKT Sh.a. të ndahet dhe shoqëritë pritëse që do të krijoheshin rishtazi janë si më poshtë:

1. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.,
2. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a.,
3. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do të merreshin përsipër nga shoqëritë pritëse sipas zonës së juridiksionit të bashkive respektive dhe me të njëjtat kushte sikur zbatohen ende nga Shoqëria që ndahet.

Ndarja është realizuar në datën 20 nëntor 2017 dhe Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.ka marrë në dorëzim të gjitha asetet sipas raportit të ndarjes në të cilin është propozuar ndarja e aktiveve neto midis shoqërive të reja në bazë të bilancit të paaudituar të shoqërisë në datën 31 dhjetor 2016. Raporti i ndarjes nga eksperti është lëshuar në datën 16 shkurt 2017.

Gjate vitit 2019 duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.18 datë 19.09.2019 “Për miratimin e Marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. dhe marrjen në dorëzim të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Kamëz” u realizua marrja në dorëzim e të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të akteve të ndarjes së shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, ndryshuar me Urdhrin nr 434 datë 05.11.2019.

Data 31.10.2019 është caktuar si datë për të bërë dorëzimin e të drejtave dhe detyrime.

Duke u bazuar sa me sipër UKB Kamza pranoi dhe mori në dorëzim nëpërmjet proces verbalit nr U-69/2/3 në date 17.12.2019.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

1.2 Informacion mbi veprimtarinë

Licënza e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me numër 19 me vendim numër 40 date 06.10.2017 dhe është vlefshme deri me 05.10.2018.

Veprimtaritë përkatëse të kualifikuar në kategoritë janë:

- Kategorja A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
- Kategorja B, Për përpunimin e ujit për konsum publik.
- Kategorja C, Për largimin e ujrave të ndotura.

Në zonat e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Tiranë dhe Kamëz, dhe Vorë.

1.3 Informacion mbi përthithjen e Shoqërisë HEC Lanabregas Sha në Ujësjetllës Kanalizime Sha

Shoqëria "HEC LANABREGAS" sh.a është krijuar si shoqëri anonime shtetërore në 31.08.2011 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë në 07.09.2011 si rezultat i një operacioni spin-off të aktiveve të prodhimit të energjisë elektrike të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Sha të përdorura prej saj, në vendndodhjen Lanabregas, Komuna Dajt Tiranë.

Në vijim të kontratës nr 1588 rep-nr 320 kol datë 08.05.2012 " Për Blerjen e Aksioneve të HEC Lanabregas sha", Ligjit 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" Ujësjetllës Kanalizime sha është shndërruar në zotëruesin në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë Hec Lanabregas Sha.

Asambleja e Aksionarëve të UKT sha në datë 16.01.2013 ka aprovuar Marrëveshjen e Bashkimit me përthithje të shoqërive Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë dhe HEC Lanabregas sha ku shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë përthithi shoqërinë HEC Lanabregas sha. Ky operacion sipas Marrëveshjes u realizua mbi të dhënat e datës 30 shtator 2012.

Më datë 18/7/2014, shoqëria HEC LANABREGAS sha është regjistruar si shoqëri me vete pranë QKR-së me NIPT L41918001E dhe aksioner 100% UKT sha me një kapital prej 10,000,000 lekë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr 13 datë 13.9.2013, me adresë Komuna Dajt Hec Lanabregas me objekt të aktivitetit prodhim i energjisë elektrike, shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të UKT Sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standadeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara më poshtë. Më poshtë paraqiten parimet kryesore kontabël të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

2.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Grupi do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(Vlerat janë në mijë Lekë)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5. Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të Grupit konsolidojnë ato të shoqërisë mëmë dhe të shoqërisë së kontrolluar prej saj me 31 dhjetor 2020. Shoqëria e Kontrolluar ka datë raportimi me 31 dhjetor 2020.

Të gjitha transaksionet dhe balancat ndërmjet shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidim, duke përfshirë fitimet e parealizuar dhe humbjet nga transaksionet ndërmjet shoqërive të Grupit.

Në rastet kur humbjet e parealizuar në shitjet e aseteve brenda grupit janë stornuar në konsolidim, aktivi është testuar edhe për zhvlerësim nga perspektiva e grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Konsoliduara janë përshtatur aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat kontabël të miratuara nga Grupi.

Fitimi ose humbja dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse e Shoqërive të Kontrolluara të blera apo të shitura gjatë periudhës njihen nga data efektive e blerjes, ose deri në datën efektive të shitjes, sipas rastit.

2.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2020, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

- Përkufizimi i një biznesi (Amendime në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Amendime në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Kuadri konceptual i rishikuar për Raportimin Financiar (Standarde të Ndryshme)
- Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos ti aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon ti aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2020:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimeve – lëshuar në maj 2017 si zëvendësim i SNRF 4 Kontratat e sigurimeve
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohen shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen me vlerën e drejtë duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra

Huatë e marra njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

(Vlerat janë në mijë Lekë)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiv.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje, rrjeti ujësjetllës dhe kanalizimeve dhe mjetet e transportit. Aktivet e marra me qera amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Baza e përlogaritjes përfshin shumën fillestare të makinerive dhe pajisjeve dhe duke zbritur vlerën e rikuperueshme të aktivit.

Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimet në asetet e UKT Sh.a.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.3. Aktive afatgjata material (vazhdim)

iv. Rënia në vlerë

Vlera e mbartur e ndërtesave, makinave dhe pajisjeve kryesore janë testuar çdo vit për rënien e mundshme në vlerë, atëherë kur ngjarjet apo kushtet e gjëndjes financiare tregojnë që shumën e mbartur e këtyre aktiveve nuk mund të rikupërohet.

Në rast se për aktivet identifikohet fakti që mbartin një rënie të vlerës së tyre, atëherë shumën e mbartur në kontabilitet zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme përfaqësohet nga shumën e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim, ku kjo e fundit është llogaritur si vlera e skontuara e flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të rregulluara nga faktorët e riskut që mbartin.

Për këto arsye grupohen sipas aftësisë së tyre për të gjeneruar flukse hyrëse të parasë bazuar në faktin që këto aktive janë të identifikueshme dhe që gjenerojnë flukse të rëndësishme të mjeteve monetare.

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë të përdorur, me vlerën e rënë të aktiveve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve, kryhen duke përdorur vlerësimin e riskut në lidhje me prodhimin dhe performancën e tyre.

Zbritja në vlerë e aktiveve, përveç emrit të mirë, aplikohet sa herë që ngjarjet të cilat kanë ecur në këtë rënie të vlerës ndryshojnë.

v. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.4. Aktivet afatgjata jomateriale (Emri i Mirë)

Emri i Mirë rezulton nga transaksioni i përthithjes së HEC nga Ujësjetllës Kanalizime dhe përfaqëson tepicën midis shumës së paguar dhe vlerës së paguar dhe kapitalit të nënshkruar shoqërisë së përthithur.

Për qëllime të testit të vlerës së Emrit të Mirë, ai alokohet në Njësinë Gjeneruese të Fitimeve të identifikuar dhe që pritet të përfitojë nga sinergjitë e kombinimit të bizneseve. Njësia e Gjenerimit të Fitimeve për të cilën është alokuar Emri i Mirë përfaqëson nivelin më të ulët brenda kompanisë mbi të cilën monitorohet Emri i Mirë.

Emri i i Mirë monitorohet në nivel të raporteve segmentare. Shoqëria një humbje nga rënia në vlerë e emrit të mirë mbi bazën të llogaritjeve fiskale me metodën lineare.

4.5. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.6 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktiv i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negocohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktiv i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Qiraja financiare

Qiraja financiare ndahet në afatshkurtër dhe afatgjatë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Detyrimet afatshkurtra të qirasë	35,573	33,908
Detyrimet afatgjatë të qirasë	99,819	63,954
	135,391	97,862

Shuma të njohura në të ardhura dhe shpenzime

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime amortizimi të aktiveve me të drejta në përdorim	39,837
Shpenzimet e interesit(të përfshira në koston e financimit)	7,171
Shpenzime qeraje që lidhen me qira afatshkurtra	45,346
Shpenzime që lidhen me qiradhënjet e aktiveve me vlerë të ulët	-
Shpenzime në lidhje me pagesat e qerasë së ndryshueshme që nuk përfshihen në detyrimet e qerasë	-
	92,353

(Vlerat janë në mijë Lekë)

4. Politikat Kontabël (vazhdim)**4.6 Aktivët me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16) (vazhdim)***Analiza e maturitetit.*

Flukset kontraktuale të paskontuara paraqiten si mëposhtë:

	31dhjetor2020
Deri në një vit	
1-5 vite	97,723
Mbi 5 vite	15,606
Totali i detyrimit për qira financiare të paskontuar	156,358

4.7. Inventarët

Inventarët janë matur me më të voglën midis Kostos Historike dhe Vlerës Neto të Realizueshme. Vlera Neto e Realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshijnë shpenzimet kryesore gjatë blerjes së inventarit dhe të dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.8. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të Grupit, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). Pjesa më e madhe të shitjeve të Degës gjenerohen nga shitja e shërbimeve të instalimit dhe mirëmbajtjes.

i) Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve

Në marrëveshjet për shitjen vetëm të shërbimeve, të ardhurat nga shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen që realizohet të konsumit. Të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes dhe azhurnimit, si dhe të shitjes së produkteve: të matësive, librezave të ujit etj, njihen në momentin e realizimit të tyre. Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin. Nëse Grupi ka pasiguri nëse do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihen mbi baza monetare. Megjithatë, nëse ka pasiguri rreth mbledhjes së një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma në lidhje me të cilën është e pamundur që të arkëtohet ajo njihet si shpenzim në zërin e kostos së mallrave të shitura.

Sipas vendimit numër 24 të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit, datë 26.02.2013 "Për një shfuqizim në vendimin e KKR" dhe nr. 29, datë 28.09.2011 "për përcaktimin e llogaritjes së sasisë së ujërave të ndotura", vendosi që sasisë të ujërave të ndotura për çdo klient do të llogariten me 100% të sasisë së ujit të konsumuar.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.8. Të ardhurat (vazhdim)

ii) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një llogari e arkëtushme është vështirë për t'u arkëtuar, Grupi zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e rikuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshëm të parashikuara të skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi në rastin e huave të cilat kanë rënie të vlerës njihen duke përdorur normën efektive origjinale të interesit.

iii) Të ardhurat nga Grantet

Qeveria e Shqipërisë ose/dhe Organizma Ndërkombëtare ofrojnë Grante shoqërisë në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim në Pozicionin Financiar ndërsa që shumën e Grantit, njihet në të ardhurat me realizimin e investimit ose shpenzimeve për realizimin e tyre. Gjithashtu Bashkitë dhe Komunitat mund të japin grante për kompensimin e çmimit të ujit apo shërbimeve të rregulluara, në këto raste të ardhurat njihen në proporcion me sasinë e ujit apo shërbimeve të rregulluara që konsumohen. Në rastin kur ofrohen grante për mbulimin e shpenzimeve të UKTsha ato njihen në të ardhura, në masën e shpenzimit të realizuar.

4.9. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

4.10. Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si të ardhur në Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurat e tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.11. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.12. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019:15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.13. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.14. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhur.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.15. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.16. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.17. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese duhet të axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.18 datë 19.09.2020 "Për miratimin e Marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. dhe marrjen në dorëzim të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Kamëz" u realizua marrja në dorëzim e të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të akteve të ndarjes së shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sha, ndryshuar me Urdhër nr 434 datë 05.11.2020. Pasqyrat Financiare të datës 31 dhjetor 2019 i përkasin shoqërisë që përfshin edhe llogaritë e UKB Kamëz.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Shoqëria kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arsyeshme sipas rrethanave.

5.1 Njohja e të Ardhurave

(i) Të Ardhurat nga shitja e produkteve të rregulluar

Njohja e të ardhurave për klientët të cilët janë objekt matjeje përfshin një vlerësim të vlerës së ujit të konsumuar dhe të tjera shërbime të lidhura midis datës së fundit të matjes dhe datës së fundit të periudhës ushtrimore. Në datën e bilancit kjo shumë është për tu faturuar në datën tjetër të matjes. Drejtimi mendon që përlllogaritja e konsumit për periudhën afërsisht 15 ditore për klientët paraqet besueshëm vëllimin e të ardhurave që realizohen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë ndryshimi në këto supozime nuk do të ketë efekte materiale në raportimin e të ardhurave.

(ii) Grantet

Një numër i caktuar grantesh janë përfshirë në librat, të përfituara nga transaksione të ndryshme me donator të ndryshëm. Drejtimi analizoi destinacionin dhe dokumentacionin e këtyre granteve. Një shumë e caktuar grantesh kanë qenë dhuruar si kontribut në materiale dhe aktive. Grantet njihen si të ardhura për pjesën e amortizimit të aktiveve për të cilat janë përfutur.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

5.2 Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paafësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozimet për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta sesa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani. Kompania testoi llogaritë e arkëtueshme të saj nëse ato kanë një rënie në vlerë në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë.

Metoda e Vlerësimit

Bazuar në politikën kontabël UKT evidenton llogaritë e Arkëtueshme për efekte të vlerësimit të vlerës së drejtë si vijon:

Vlerësuar Individualisht

UKT fillimisht vlerëson nëse ka evidencë të humbjes së vlerës në rang individual dhe që kjo evidencë është materiale në grupin e aktivitetit financiar.

Nëse UKT identifikon sa më sipër që nuk ka evidencë për humbje vlere atëherë ajo e përfshin aktivin në një klasë të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit dhe i vlerëson ata kolektivisht për rënien në vlerë. Aktivitet që janë vlerësuar individualisht për rënien në vlerë dhe për të cilët humbja nga rënia në vlerë është ose vazhdon të njihet nuk janë përfshirë në një vlerësim kolektiv për rënien në vlerë.

Vlerësuar Kolektivisht

Flukset e ardhshme monetare në një grup të aktiveve financiare që janë vlerësuar kolektivisht për rënien në vlerë parashikohen në bazë të eksperiencës së humbjes historike për aktivitet me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit me ato në grup.

Në rastet kur UKT nuk ka një eksperiencë humbjeje specifike ose ka një eksperiencë të pamjaftueshme, atëherë përdor eksperiencën e shoqërive që operojnë në të njëjtin treg.

Humbjet janë rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të reflektuar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë ndikuar periudhën në të cilën është bazuar eksperiencën e humbjes historike dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare të parashikuara reflektojnë dhe janë lidhur në mënyrë konsistente me ndryshimet e të dhënave të lidhura nga periudha në periudhë (të tilla si normat

papunësisë, çmimet e pronës, çmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve të shkaktuara në grup dhe magnitudës së tyre).

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e ardhshme të parashikuara janë rishikuar rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis humbjes së parashikuar dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Vlerësimi i Llogarive të Arkëtueshme

Bazuar në specifikën e aktivitetit të Kompanisë si duke marrë në konsideratë politikat e UKT sh.a.për vjeljen e detyrimeve të prapambetura me vështirësi arkëtimi, Sektori i Menaxhimit të Riskut, në varësi të mënyrës së matjes së konsumit të ujit dhe moshës së debisë, ka klasifikuar portofolin e debisë sipas kategorive të abonentëve në 4 klasa Risku.

Sipas mënyrës së matjes për çdo kategori abonenti dhe moshës së debisë, është klasifikuar debia deri më datë 31.12.2020 sipas klasave të riskut të përcaktuara dhe në bazë të kësaj është përllogaritur vlera e provigjionimit.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

5.3 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

5.4 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

5.5 Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në shoqëri. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar të lehtësohen ende nuk është e mundur vlerësimi i këtij efekti në flukset e e parave dhe zhvlerësimet e klientëve. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në mijë Lekë)

6. Aktivet afatgjata materiale

Kosto

Gjendja më 1 janar 2019	Toka	Ndërtesa	Rrjeti Ujesjelles	Rrjeti Kanalizim	Makineri dhe Pajisje Pune	Mjete Transporti	Pajisje zyre	Punime në proces	Asete në magazinë	Totali
Shtesa të vitit	-	43,770	-	15,158	13,959	66,108	77,843	2,400,568	16,573	2,633,979
Transferime & Sisteme UKT	-	237,060	175,905	64,493	10,612	22,596	(3,367)	(477,459)	(29,840)	-
Pakesime aktivesh dhe huaje bazuar ne aneks kontrate	-	-	-	-	-	-	-	(357,416)	(738)	(358,154)
Dalje per transferim UKK	(9,350)	(3,005)	(119,778)	-	(855)	-	-	(208,688)	-	(341,676)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,209,754	4,323,671	4,889,715	1,336,178	218,554	170,225	275,356	3,254,489	63,708	16,741,650
Shtesa të vitit	-	-	-	-	27,553	110,686	34,609	2,245,708	8,447	2,427,003
Transferime & Sisteme UKT	-	-	121,305	42,456	67	-	-	(163,760)	(68)	-
Dalje per transferim UKK	-	-	-	-	(174)	(108)	(2,020)	-	2,302	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,200,404	4,601,496	5,067,147	1,458,285	269,716	369,507	382,421	6,693,442	60,384	21,102,802

Amortizimi i akumuluar

Gjendja më 1 janar 2019	-	2,275	-	-	12,208	1,243	1,217	-	-	16,943
Amortizim	-	86,923	126,727	34,411	27,422	21,219	59,565	-	-	356,267
Pakesim amortizimi	-	-	-	-	(219)	-	(433)	-	652	-
Dalje per transferim UKK	-	(91)	(6,280)	-	(159)	-	-	-	-	(6,530)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	89,107	120,447	34,411	39,252	22,462	60,349	-	652	366,680
Amortizim	-	90,114	129,514	35,648	18,710	31,677	62,992	-	-	368,655
Dalje per transferim UKK	-	-	-	-	(112)	(40)	(890)	-	1,042	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	179,221	249,961	70,059	57,850	54,099	122,451	-	1,694	735,335
Zhvlerësimi më 31 dhjetor 2019	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900
Zhvlerësimi më 31 dhjetor 2020	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900
Vlera neto kontabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9,800
Vlera Neto Kontabël 31 dhjetor 2019	2,200,404	4,512,389	4,825,395	1,381,418	198,256	236,467	289,483	4,611,494	48,913	18,304,219
Vlera Neto Kontabël 31 dhjetor 2020	2,200,404	4,422,275	4,817,186	1,388,226	207,104	315,408	259,970	6,693,442	58,552	20,362,567

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në mijë Lekë)

7. Te drejta ne perdorim

	Asete me të drejtë përdorimi	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2019	-	-
Shtesa	133,069	133,069
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	133,069	133,069
Shtesa	75,979	75,979
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	209,048	209,048
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2019	-	-
Amortizimi i vitit	38,000	38,000
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	38,000	38,000
Amortizimi i vitit	39,837	39,837
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	77,837	77,837
Gjendja neto më 31 dhjetor 2019	95,069	95,069
Gjendja neto më 31 dhjetor 2020	131,211	131,211

8. Parapagime për aktive të tjera afatgjata

Parapagime për aktive të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AAGJ Parapagime për aktive të patrupëzuara	19,351	19,351
	19,351	19,351

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në mijë Lekë)

9. Inventarë

Balanca e inventarëve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Materiale - rrjetet	358,896	398,698
Pjesë këmbimi	59,405	51,022
Materiale konsumi	27,893	24,094
Materiale kancelari	5,300	6,209
Kimikate	1,625	279
Karburant	6,765	9,082
Inventar i imët	21,033	20,256
Të tjera	21,929	17,947
Materiale jashtë përdorimit	71,155	71,155
Humbje vlere e aktivitet afatshkurtër	(102,846)	(112,953)
	471,155	485,789

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Çelje	112,953	112,953
Rimarrje për vitin	(10,495)	-
Zhvlerësimi për vitin	388	-
Gjendja më 31 dhjetor	102,846	112,953

10. Llogari të arkëtueshme

Balanca e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Konsumator familjar	2,927,043	2,724,001
Subjekte private	723,760	723,711
Ente buxhetore	132,025	89,308
Komuna/ Njësi administrative	289,027	215,127
Të tjerë	1,244,466	734,527
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(774,042)	(628,875)
Llogari te arkëtueshme neto UKT	4,542,279	3,857,799
Llogari të arkëtueshme neto të HEC Lanabregas	19,285	28,003
	4,561,564	3,885,803

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në mijë Lekë)

10. Llogari të arkëtueshme (vazhdim)

Lëvizjet në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Çelje	628,875	695,341
Rimarrje për vitin	(97,863)	(28,112)
Zhvlerësimi për vitin	243,030	17,707
Paksim llogarite e arkëtueshme Kamze	-	(56,061)
Gjendja më 31 dhjetor	774,042	628,875

11. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogarite të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Debitore dhe paradhënie për personelin	9,681	9,970
Zhvlerësime për debitorë personeli	(9,527)	(9,527)
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	316	30,952
TVSH	71,826	7,131
Diferenca nga nipti i ndarjes për UK Kamzen	241,201	241,201
Debitore të tjera Permbarimi	73,869	66,233
	387,366	345,960

12. Tatimi mbi Fitimin

Balanca e aktiveve tatimore të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagim për Tatim Fitimin	87,252	81,500
	87,252	81,500

13. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Balanca e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime	330	330
Shpenzime të shtyra komisione disbursimie kredie	58,701	39,595
Shpenzime të shtyra të tjera	2,910	-
	61,941	39,925

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në mijë Lekë)

14. Mjetet monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjetet monetare në arkë e në bankë të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Likuiditete në bankë	340,482	236,289
Mjete monetare në tranzit	15,721	9,611
	356,203	245,900

15. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është në vlerën 6,792,760 mijë Lekë.

	31 dhjetor 2020
Numri i aksioneve	6,792,760
Vlera nominale (në mijë lekë)	1
	6,792,760

Aksionet zotërohen 100% Bashkia Tiranë.

Fitimi i mbartur

Shuma prej 1,759,839 mijë Lekë përfaqëson fitimin e mbartur në 2020 dhe shuma prej 1,763,323 Lekë nga viti paradhës.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 380,136 mijë Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2020. (2019: 886,002 mijë Lekë)

16. Hua afatgjata

Balanca e huave afatgjata të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Bovilla - Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID - 95/007/00	351,371	422,753
